



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.4890/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Shpresa Veselaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Alban Luta nga Prishtina, të cilin e përfaqëson me prokurë Blerim Çela, avokat nga Prishtina; kundër të paditurës Laura Sement shtetase franceze, me vendbanim në rrugën "282 Çajupi", në lagjen Tophane, tani me adresë të panjohur, për zgjidhjen e martesës, duke vendosur sipas Propozimit të paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurën, jashtë seancës gjyqësore me datën 08.04.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

I- Të paditurës Laura Sement shtetase franceze, me vendbanim në rrugën "282 Çajupi", në lagjen Tophane, tani me adresë të panjohur, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Shkumbin Marevci, avokat nga Prishtina, i cili ka për obligim që të paditurën t'a përfaqësoj në procedurën për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim në lëndën C.nr.4890/20.

II- Sipas dispozitës së nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i saj me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se ja ka caktuar kujdestarin.

III- Ky aktvendim do të shpallët në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në Tabelën e shpalljeve të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij, pranë kësaj gjykate me dt. 10.11.2020 ka paraqitur padi për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, kundër të paditurës Laura Sement shtetase franceze, me vendbanim në rrugën "282 Çajupi", në lagjen Tophane, tani me adresë të panjohur.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me dt. 03.02.2022, në të cilën seancë ka prezantuar përfaqësuesi me prokurë i paditësit, ndërsa për të paditurën askush nuk ka prezantuar në seancë. Duke qenë se adresa e të paditurës është e panjohur dhe me qëllim që çështja të mos zvarritet nga ana e të paditurës, paditësi i propozoi gjykatës që të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, sipas dispozitës së nenit 79.3 të LPK-së, për të paditurën Laura Sement shtetase franceze, me vendbanim në rrugën "282 Çajupi", në lagjen Tophane, të cilës tani nuk i dihet adresa.

Duke vendosur sipas propozimit të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 79 par. 3 pika (a) të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurën. Andaj, gjykata vendosi që të paditurës, t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Shkumbin Marevci, avokat nga Prishtina, i caktuar nga lista e avokatëve të Odës së Avokatëve të Kosovës, i cili do të përfaqësoj interesat e të paditurës në këtë çështje juridiko- civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C. nr. 4890/20 dt. 08.04.2022

Gjyqtarja
Shpresa Veselaj

S. Veselaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.